



Asociacioni i Komunave të Kosovës

R A P O R T

nga

Takimi i Kolegjiut për Arsim dhe Kulturë

Istog, 8 korrik 2011

Për: Ertan Munoglu – Menaxher i Programit i AKK-së

Nga: Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjiumeve të AKK-së

Lënda: Raport nga takimi i Kolegjiut për Arsim dhe Kulturë

HYRJE

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) në bashkëpunim me Kryesinë e Kolegjiut për Arsim dhe Kulturë organizoi takimin e radhës të këtij Kolegjiut me 8 korrik 2011 (e premte) me fillim nga ora 11:00 në Restorantin „Trofta“ në Istog.

Takimi kishte për qëllim të diskutohej rendi i ditës i përcaktuar më parë nga Kryesia me këto pika:

- Pjesëmarrje në procesin legjislativ për ligjin për arsimin parauniversitar
- Trajnimi i mësimeve për përdorimin e metodologjive bashkëkohore në mësime
- Hartimi/harmonizimi i planeve strategjike zhvillimore komunale për arsim për periudhën 3 vjeçare

Në këtë takim morën pjesë Drejtorë të Arsimit nga Komunitet e Kosovës, si dhe përfaqësues të AKK-së. Takimi u kryesua nga zv.kryesuesi i Kolegjiut për Arsim dhe Kulturë, z. Qerim Selimi.

PËRMBLEDHJE

Në hyrje të takimit zv. kryesuesi prezantoi dhe uroj mirëseardhjen e përfaqësuesve të KE-së, USAID-it dhe SWISSCONTACT-it për pjesëmarrje dhe prezantim të projekteve në sferën e arsimit. Me këtë rast zv. kryesuesi paraqiti edhe ndryshimin e rendit të ditës, me tre pika shtesë në prezantimin e këtyre projekteve specifike nga zyrtarët e këtyre organizatave.

Në vazhdim të takimit z. Alejtin Berisha - konsulent nga USAID - Basic Education Program (BEP) bëri prezantimin e draftit të Standardeve e Praktikës Profesionale për Drejtorë të Shkollave në Kosovë, të përpiluar nga grupi punues i udhëhequr nga USAID - BEP dhe Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Bashkangjitur në **aneksin 1** do të gjeni draftin e prezantuar në takim me pikat kryesore.

z. Berisha po ashtu informoi të pranishmit se janë në diskutim me MASHT-in nëse këto standarde do të jenë të detyrueshme. Deri në shtator do të procedohet me versionin përfundimtar i cili mund të shndërrohet në Udhëzim Administrativ nga MASHT-i ku edhe do të jenë të obligueshme këto kriteret në përzgjedhjen e drejtorëve të rinj në shkolla.

Drejtorët kërkuan që në versionin përfundimtar të përfshihen edhe ato vërejtje dhe sugjerime të parashtruara nga drejtorët në takimet e mëparshme me zyrtarët e këtij projekti. Si një kërkesë e veçantë u kërkua që patjetër në versionin përfundimtar të përfshihet ruajtja e vendit të punës për drejtorët e shkollave të cilët do të përzgjidhen me konkurs - kjo do të mundësonte aplikimin e personave profesional për këto poste sepse u garanton një punë më të sigurt dhe afatgjatë.

Më pas morri fjalën z. Adnan Osmani – asistent projekti dhe znj. Nefertita Bardhi – koordinatore nga SWISSCONTACT për paraqitjen e projektit në përkrahje të Arsimit Profesional (2010-2012) dhe projektit për grante shkollare. Në **aneksin 2** do të gjeni prezantimin e projektit.

Si pikë shtesë z. Helmut Schramke - udhëheqës i projektit, prezantoi pilot projektin e financuar nga KE-ja në ngritjen e teknologjisë informative në fushën e edukimit. Informatat rreth këtij projekti i gjeni të bashkangjitura në **aneksin 3**.

Gjatë diskutimit të temës rreth pjesëmarrjes në procesin legjislativ anëtarët e Kolegjiutit treguan se gjatë takimeve të rregullta në MASHT janë paraqitur vërejtjet e tyre individualisht sa i përket ndryshimeve në draft-ligjin për arsimin parauniversitar, por të gjithë ranë dakord që versioni përfundimtar i draft-ligjit të përcillet edhe njëherë tek të gjitha drejtoritë komunale për komente dhe vërejtje të mundshme për ndryshim. Pastaj duke marrë për shkas këtë rast do të duhej të mblidhet edhe Kryesia me qëllim rishikimin e harmonizimit të këtyre kërkesave për ndryshim dhe si përfundim të përpilohet një kërkesë zyrtare që do të përcillet edhe MASHT-it përmes AKK-së.

Kolegjiutit kërkoi që trajnimi i mësimitdhënësve të bashkërendohet me MASHT-in dhe DKAK-ët në mënyrë që këto trajnime të ofrohen nga programe të licencuara dhe të akredituara si dhe që MASHT-i të gjej mundësi të mbështetje financiare për këto trajnime. Trajnimet do të duhet të jenë në faza të caktuara e të vazhdueshme si dhe të jenë të vlerësuara, por në të njëjtën kohë edhe të reflektohen në paga të mësimitdhënësve nga MASHT-i.

Një pengesë tjetër u identifikua edhe rikualifikimi i mësimitdhënësve nga MASHT-i. Ku komunat shprehën pakënaqësi në këtë aspekt sepse ekziston një mos-proporcion i madh në numrin e mësimitdhënësve nga komunat e ndryshme të cilët marrin pjesë në procesin e rikualifikimit.

Gjatë takimit u diskutua edhe për nevojën e harmonizimit të planeve strategjike zhvillimore komunale me planet komunale për arsim. Këto plane duhet të jenë obligueshme për të gjitha komunat, njëjtë të përcillen edhe tek Ministrinë përgjegjëse për verifikim se sa janë ato të zbatueshme dhe në harmonizim me ligjet në fuqi. Gjithashtu edhe donatorët e ndryshëm të cilët përkrahin infrastrukturën shkollore në komuna me projekte të ndryshme, duhet të jenë në përputhje me planet zhvillimore komunale.

REKOMANDIMET:

- AKK të organizoj takimin e Kryesisë për të rishikuar draftin e fundit të ligjit për arsimin parauniversitar dhe të përcjell vërejtjet/komentet përfundimtare MASHT-it.
- Trajnimet e mësimitdhënësve të bëhen nga institucione të licencuara e akredituara dhe këto trajnime të jenë pjesë e ngritjes së pagës nga MASHT-i
- Rikualifikimi i mësimitdhënësve të bëhet në mënyrë proporcionale në të gjitha komunat
- Planet zhvillimore për arsim të jenë në harmoni me planet e përgjithshme për zhvillim komunal dhe ligjet në fuqi.